



06/08/2022

Tropojë – Finalizohet operacioni policor antikanabis i koduar “Rrjeta”

Sekuestrohen drogë, **armë** zjarri dhe municion luftarak.

Vijojnë operacionet e njëpasnjëshme për goditjen e veprimtarive kriminale në fushat e narkotikëve dhe **armë**mbajtjes pa leje.

, i zhvilluar nga DVP Kukës, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Tropojë, Forcën e Posaçme Operacionale në Policinë e Shtetit dhe me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Qarkullonin me rreth 8 kilogramë kanabis dhe **armë** zjarri në automjet, vihen në pranga 3 shtetas.

Sekuestrohen rreth 8 kilogramë lëndë e dyshuar narkotike kanabis, një **armë** zjarri automatik dhe municion luftarak.

Në vijim të punës për goditjen e veprimtarive kriminale në fushat e narkotikëve dhe **armë**mbajtjes pa leje, bazuar dhe informacionet e siguruara në rrugë operative, shërbimet e Policisë kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar operacionin policor të koduar “Rrjeta”, si rezultat i të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

-E. Gj., 24 vjeç, banues në Geghysen, Tropojë, F. S., 34 vjeç, banues në Bugjon, Pukë dhe E. M., 22 vjeç, banues në Fierzë, Tropojë.

Këta shtetas u kapën në flagrancë nga shërbimet e Policisë, në vendin e quajtur “Ura e Drinit”, Fierzë, duke udhëtuar me automjetin tip “Mitsubish”, në të cilin, gjatë kontrollit, shërbimet e Policisë gjetën rreth 8 kilogramë lëndë të dyshuar narkotike kanabis, 1 **armë** zjarri automatik, si dhe një karikator me 30 fishekë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Vijojnë hetimet për identifikimin dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të personave të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Mbajtja pa leje e **armëve**, **armëve** shpërthyesë dhe i municionit”.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

🔄 Share

📘 Share

🐦 Share

in Share

✉ Email

◀ Lushnjë – Ndezi zjarr në tokën e tij, për pasojë u dogj një sipërfaqe toke me ullinj, në pronësi të një shtetasi tjetër, procedohet penalisht 29-vjeçari

Krujë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Kubikët” ▶